

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-094/15

**Prishtinë
13 shtator 2017**

Në çështjen juridike të:

M. J.

Pala ankuese

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga Beshir Islami, kryetar i kolegjit, Anna Bednarek dhe Isa Kelemendi, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/220/2013 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA50836), të datës 27 nëntor 2013, pas shqyrtimit gjyqësor të mbajtur më 13 shtator 2017, mori këtë:

AKTGJYKIM

1. Ankesa e paraqitur nga M. J. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/220/2013 të datës 27 nëntor 2013, lidhur me kërkesën e regjistruar në AKP me numër KPA50836, refuzohet si e pabazuar.
2. Vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/220/2013 i datës 27 nëntor 2013, sa i përket kërkesës së regjistruar në AKP me numër KPA50836, vërtetohet.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Më 30 nëntor 2007, M.J. (tani e tutje: pala ankuese”) ka paraqitur kërkesë pranë Agjencisë Kosovare të Pronës duke sqaruar se babai i saj i ndjerë M. M. ka qenë bartës i së drejtës pronësore dhe ka kërkuar ri-posedimin e pronës së paluajtshme e cila gjendet në vendin e quajtur Zllakuqan, Komuna e Klinës, ngastra kadastrale nr. 371/1 me sipërfaqe prej 00.60.56 ha (tani e tutje: prona e kërkuar). Ajo pretendon se e ka humbur pronën e kërkuar për shkak të rrethanave që lidhen me konfliktin e armatosur të vitit 1998/99 i cili ka ndodhur në Kosovë dhe ka cekur datën 17 qershor 1999 si ditën e humbjes së pronës.
2. Në mbështetje të kërkesës së saj, M. J. i ka dorëzuar AKP-së këto dokumente:
 - Kopjen e kontratës së blerjes të lidhur më 12 dhjetor 1958 në mes M. J. si shitës dhe M. M. si blerës i pronës së kërkuar. Nënshkrimet në fund të kontratës janë legalizuar nga nëpunësi i Gjykatës së Qarkut në Gurakoc me numër 425/58.
 - Kopjen e certifikatës së martesës nr. 10 të lëshuar nga Zyra e Regjistrimit Civil në Komunën e Plavës, në Mal të Zi më 15 nëntor 2007, duke dëshmuar lidhjen familjare në mes të palës ankuese dhe babait të saj të ndjerë.
 - Kopjen e certifikatës së lindjes nr. III-200-3-1639/2008-07 të lëshuar nga Zyra e Regjistrimit Civil në Komunën e Kragujevcit më 19 maj 2008, duke dëshmuar lidhjen familjare në mes të palës ankuese dhe babait të saj të ndjerë.
 - Kopjen e fletës poseduese nr. 46 të lëshuar nga Instituti i Gjeodezisë i Republikës së Serbisë, Zyra për patundshmëri dhe kadastër për Komunën e Klinës më 15 shtator 2008, në të cilën figuron se prona e kërkuar është regjistruar në emër të M. M.
 - Kopjen e certifikatës së vdekjes nr. 6 të lëshuar nga Zyra e Regjistrimit Civil në Komunën e Klinës më 24 gusht 2009, ku figuron se M. M. ka vdekur më 7 gusht 1991 në vendin e quajtur Radulovac.
3. Më 25 tetor 2013, Sekretariati Ekzekutiv i AKP-së ka bërë njoftimin fizik të pronës dhe prona e kërkuar është gjetur të jetë e zënë nga një person i panjohur. Pas njoftimit të pronës së kërkuar dhe brenda afatit ligjor prej 30 ditësh, askush nuk është paraqitur si palë përgjegjëse ose palë e interesuar para KKPK-së, kështu që kërkesa është konsideruar e pakontestueshme.
4. Sipas raporteve të verifikimit, të gjitha dokumentet e dorëzuara nga pala ankuese janë verifikuar pozitivisht.

5. Me anë të vendimit KPCC/D/C/220/2013 të datës 27 nëntor 2013, KKPK-ja ka hedhur poshtë kërkesën e palës ankuese në bazë të nenit 11.4 të ligjit nr. 03/L-079, pasi që kërkesa paraprakisht është shqyrtuar dhe vendosur me vendim administrativ të formës së prerë. Komisioni ka sqaruar se prona e kërkuar ka qenë objekt i rishikimit dhe vendimit të KKPK-së tashmë në shkurt 2013. Pala ankuese ka paraqitur një kërkesë tjetër të regjistruar në AKP me numër KPA50832. Objekti i asaj kërkesë ka qenë ri-posedimi i pronës së kërkuar.
6. Më 30 tetor 2014, palës ankuese i është dorëzuar vendimi. Më 28 nëntor 2014, ajo ka paraqitur ankesë.

Pretendimet e palës ankuese

7. Pala ankuese pretendon se vendimi i KKPK-së është bazuar në vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe në zbatim të gabuar të ligjit material. Ajo thekson se nuk është e vërtetë që lënda tashmë është vendosur me vendim gjyqësor apo administrativ dhe se ajo nuk ka qenë në dijeni për një rrethanë të tillë. Prona e kërkuar e cila është objekt i kërkesës KPA50836 asnjëherë nuk ka qenë në procedurë administrative apo gjyqësore. Në përfundim, pala ankuese ka kërkuar shqyrtimin e kërkesës përsëri dhe ndryshimin e vendimit të KKPK-së duke ia aprovuar ri-posedimin në favor të saj.

Arsyetimi ligjor

8. Gjykata Supreme, pas shqyrtimit të pretendimeve të ankesës dhe përmbajtjes së shkresave të lëndës, konstaton se vendimi i KKPK-së nuk përmban asnjë gabim thelbësor apo zbatim të gabuar të ligjit material në fuqi, dhe as nuk bazohet në vërtetim të gabuar apo jo të plotë të fakteve. Prandaj, ankesa nuk mund të aprovohet.
9. Më 30 nëntor 2007, pala ankuese ka paraqitur kërkesë në AKP. Kërkesa është regjistruar nën numrin KPA50832. Objekti i kësaj kërkesë ishte ngastra kadastrale nr. 371/1 me sipërfaqe prej 00.60.56 ha, e cila gjendet në Komunën e Klinës, në Zllakuqan. Me vendimin KPCC/D/A/186/2013 të lëshuar më 13 shkurt 2013, Komisioni ka vërtetuar se M. M. ishte pronar i pronës së kërkuar, prandaj, pala ankuese kishte të drejtë në posedimin e pronës së kërkuar (ngastra kadastrale nr. 371/1 dhe ngastra kadastrale nr. 371/2). Vendimi i përmendur i është dorëzuar palës ankuese më 31 korrik 2013. Ajo e ka nënshkruar fletëdërgesën dhe e ka bashkëngjitur një kopje të letërnjoftimit të saj.
10. Po të njëjtën ditë, pala ankuese ka paraqitur një kërkesë tjetër për ri-posedimin e ngastrës së njëjtë të tokës. Kërkesa është regjistruar me numër të ndryshëm, përkatësisht: KPA50836. Kjo e fundit është objekt i ankesës në lëndën në fjalë. Sidoqoftë, sipas nenit 11.4 të Ligjit nr. 03/L-079 kërkesa e njëjtë nuk mund të shqyrtohet dhe të vendoset dy herë. Duke pasur parasysh se KKPK-ja ka vendosur më parë lidhur me të njëjtën kërkesë të palës ankuese, kjo kërkesë duhet të hidhet poshtë, pasi që vendimi KPCC/D/A/186/2013 është lëshuar si rezultat i një procedure administrative.
11. Prandaj, Gjykata Supreme konsideron se vendimi i KKPK-së është i drejtë dhe bazohet në dispozitat ligjore të zbatuara drejtë të nenit 11.4 (c) të Ligjit nr. 03/L-079. Rrjedhimisht, në përputhje me nenin 13.3 (c) të Ligjit Nr. 03/L-079 dhe nenin 195.1 (d) të Ligjit mbi procedurën kontestimore, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këshillë juridike

Në pajtim me nenin 13.6 të Ligjit 03/L-079, ky aktgjykim është i formës së prerë dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike

Beshir Islami Kryetar i Kolegjit

Anna Bednarek, Gjyqtare e EULEX-it

Isa Kelmendi, Gjyqtar

Bjorn Olof Brautigam, Referent i EULEX-it